DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 0204-1097/3
Data 21.05.2021

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Ramiz Lladrovci,** Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>**Labinot Halilaj,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi,** Ministër i MAPL-së<br>**Trim Berisha,** Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 06.05.2021 Nr.0204-1097/2 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllogocit | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim i Kuvendit të Komunës Nr. 12-462/01-17668 për shfuqizimin e pikës 11 të nenit 3 të Vendimit Nr. 12-353-31851, të datës 23.07.2014, që i është dhënë prona komunale në shfrytëzim Vjollca Gashi nga Komorani |
| I miratuar më datë: 28.04.2021 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.04.2021 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËS-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-1097/3
Data Datum Date 21-05. 2021

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Ramiz Lladrovci**, gradonačelnik opštine Glogovac<br>**Labinot Halilaj**, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac | |
| Cc: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-a<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Elbert Krasniqi**, ministar MALS -a<br>**Trim Berisha**, zamenik generalnog sekretara MALS -a, | |
| Od: | **Venera Çerkini**, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS | Datuma, 06.05.2021 br. 0204-1097/2 |
| Službenik za utvrđivanje pravne procene:<br>Službenik-ca za izradu pravne procene: | **Xhevat Tafa**, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br>**Vjosa Ahmetaj**, viša službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac | |
| Vrsta odluke: | Odluka Skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačelniče,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka Skupštine opštine br. 12-462 / 01-17668 za ukidanje tačke 11. člana 3. Odluke br. 12-353-31851, od 23.07.2014. godine, opštinska imovina koja je data na korišćenje Vjollca-i Gashi iz Komorana |
| Usvojena dana, 28.04.2021. godine, |
| Predložena za razmatranje u MALS dana, 28.04.2021. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu **u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi**.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

**Republika e Kosovës**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

HYRESA/…ZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 28.04.2021

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
|---|---|---|---|
| -U1- | 0204-1097/2 | | |

Nr 12-46210/-12668 dt. 23.04.202

Bazuar në nenin 11.12 dhe 40, pika 40.2 nën l.të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40, nenit 34,pika 34.6, të Statutit te Komunës së Drenasit, nenit 22 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 paragrafit 5 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhenies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 110, të Ligjit *Nr.* 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-020/04-15853, të datës 19.04.2021, *të* komisionit profesional mbi verifikimin e përmbushjes se kontratës lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë, në parcelën nr. 244/4, në zonën kadastrale Komoran. Kuvendi i Komunës Drenas në mbledhjen e rregullt më datë 28.04.2021, miratoi këtë:

## V E N D I M

**PËR SHFUQIZIMIN E PIKES 11 TË NENIT 3 TË VENDIMIT NR. 12-353-31851, TË DATË 23.07.2014, QË I ISHTE DHENË PRONA KOMUNALE NË SHFRYTEZIM VJOLLCA GASHI NGA KOMORANI**

**Neni 1**

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Pronës Komunale në Zonen Kadastrale në Komoran, që i ishte dhënë në shfrytëzim Vjollca Gashi nga Komorani, pjesa e ngastrës kadastrale Nr. 244/5, në zonën kadastrale Komoran, në sipërfaqe prej 0.20 ha, në vendin e quajtur "Stopanica", me kulturë kullosë, qe i ishte dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite.

**Neni 2**

Shfuqizohet pika 11 e nenit 3 të vendimit Nr. 12-353-31851, të datës 23.07.2014, të Kuvendit të Komunës së Drenasit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite të pronës komunale, në bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 353-46320, e datës 23.10.2014, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim Vjollca Gashi në pjesën e ngastrës kadastrale Nr. 244/5, me kulture kullosë, në sipërfaqe prej S=0.20 ha në vendin e quajtur "Stopanica" në zonën kadastrale Komoran.

**Neni 3**

Me këtë vendim do të njoftohen institucionet si dhe shfrytëzuesja e pronës komunale Vjollca Gashi nga Komorani.

## Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

## Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

**Republika e Kosovës**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

**Nr** 12-462101-17668 **dt.**28.04.**2021**

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, pika 40.2 nën l,të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40, nenit 34,pika 34.6, të Statutit te Komunës së Drenasit, nenit 22 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 paragrafit 5 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 110, të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-020/04-15853, të datës 19.04.2021, të komisionit profesional mbi verifikimin e përmbushjes se kontratës lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë, në parcelën nr. 244/4, në zonën kadastrale Komoran, Kuvendi i Komunës Drenas në mbledhjen e rregullt më datë **28.04.2021**, miratoi këtë:

# V E N D I M

**PËR SHFUQIZIMIN E PIKES 11 TË NENIT 3 TË VENDIMIT NR. 12-353-31851, TË DATË 23.07.2014, QË I ISHTE DHENË PRONA KOMUNALE NË SHFRYTEZIM VJOLLCA GASHI NGA KOMORANI**

**Neni 1**

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Pronës Komunale në Zonen Kadastrale në Komoran, që i ishte dhënë në shfrytëzim Vjollca Gashi nga Komorani, pjesa e ngastrës kadastrale Nr. 244/5, në zonën kadastrale Komoran, në sipërfaqe prej 0.20 ha, në vendin e quajtur "Stopanica", me kulturë kullosë, qe i ishte dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite.

**Neni 2**

Shfuqizohet pika 11 e nenit 3 të vendimit Nr. 12-353-31851, të datës 23.07.2014, të Kuvendit të Komunës së Drenasit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite të pronës komunale, ne bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 353-46320, e datës 23.10.2014, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim Vjollca Gashi në pjesën e ngastrës kadastrale Nr. 244/5, me kulture kullosë, në sipërfaqe prej S=0.20 ha në vendin e quajtur "Stopanica" në zonën kadastrale Komoran.

**Neni 3**

Me këtë vendim do të njoftohen institucionet si dhe shfrytëzuesja e pronës komunale Vjollca Gashi nga Komorani.

**Neni 4**

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

**Neni 5**

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Labinot Halilaj**

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70314035-00244-5

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | 28/04/2021 |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 28.04.2021 - 13:55 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Komoran / Komorane / Kamaran |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70314035-00244-5** | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | **1619** | | | 27.01.2020 |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| STOPONICA-STOPONICA/STOPONICA-STOPONICA/STOPONICA-STOPONICA | | STOPONICA-STOPONICA | | 27.01.2020 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljiste/Construction land | Truall/Zemliste/Land | | 1619 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | Komuna e Gllogocit | 600316708 | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC / | | FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI | 1/1 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Komoran

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70314035-00244-5 | Parcelë / Parcela / Parcel | 1619 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:438

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 28.04.2021
Koha/ Vreme/ Time: 01:59:10
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aprovær: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**Nr** 01-462/01-17332 **dt.** 26.04.**2021**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h)të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në vështrim të nenit 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 22 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 paragrafit 5 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 110 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-020/04-15853, të datës 19.04.2021 të komisionit profesional mbi verifikimin e përmbushjes se kontratës lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë, në parcelën nr.244/4, në zonën kadastrale Komoran, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë___________vitit 2021 të aprovoi këtë:

# PROPOZIM VENDIM

**PËR SHFUQIZIMIN E PIKES 11 TË NENIT 3 TË VENDIMIT NR. 12-353-31851, TË DATË 23.07.2014, QË I ISHTE DHENË PRONA KOMUNALE NË SHFRYTEZIM VJOLLCA GASHI NGA KOMORANI**

**Neni 1**

Më këtë Propozim- Vendim, miratohet Kthimi i Pronës Komunale në Zonen Kadastrale në Komoran, që i ishte dhënë në shfrytëzim Vjollca Gashi nga Komorani, pjesa e ngastrës kadastrale Nr.244/5, në zonën kadastrale Komoran, në sipërfaqe prej 0.20 ha, në vendin e quajtur "Stopanica", me kulturë kullosë, qe i ishte dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite.

**Neni 2**

Shfuqizohet pika 11 e nenit 3 të vendimit Nr.12-353-31851, të datës 23.07.2021, të Kuvendit të Komunës së Drenasit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite të pronës komunale, ne bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 353-46320, e datës 23.10.2014, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim Vjollca Gashi në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.244/5, me kulture kullosë, në sipërfaqe prej S=0.20 ha në vendin e quajtur "Stopanica" në zonën kadastrale Komoran.

**Neni 3**

Me këtë vendim do të njoftohet Vjollca Gashi nga Komorani.

**Neni 4**

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Drenasit dhe konfimimit ligjor nga MAPL-ja.

**Kryetari i Komunës**

Ramiz Lladrovci

**ARSYETIM**

Me vendimin Nr.12-353-31851, të datës 23.07.2021 i Kuvendit te Komunës se Drenasit, respektivisht nenin 3 pika 11, i është dhëne në shfrytëzim afatgjatë prona komunale Vjollca Gashit, me bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 353-46320 e datës 23.10.2014, në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.244/5, me kulture kullosë, në sipërfaqe prej S=0.20 ha në vendin e quajtur "Stopanica" në zonën kadastrale Komoran për realizimin e programit investiv.

Sipas komisionit profesional shfrytëzuesi është pajtuar se parcelën e marrë në shfrytëzim do ta shfrytëzoi sipas kritereve, siç janë:

Në këtë parcelë do ta ndërtoi objektin sipas lejes së ndërtimit që i lëshohet nga organi kompetent i Komunës së Drenasit që ta filloi punën në afatë prej 6 muajsh, që plani dinamik për realizimin e projektit të jetë 18 muaj, prej ditës së nënshkrimit të kontratës, që të marr lejen për përdorimin e objektit, që të paguaj qiranë, të ndikoj në rritjen e vlerës së pronës.

Pas analizimit të të dhënave të cekura në kontratë dhe konstatimit të gjendjes faktike në teren me datën 15.04.2021, të dhënave të konfirmuara nga Drejtoria për Gjeodezi , Kadastër dhe Pronës, Drejtoria për Planifikim Hapësinorë dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, komisioni konstaton se :

Shfrytëzuesi afatgjatë i tokës, nuk e ka regjistruar të drejtën e shfrytëzimit në RDPP, në Sektorin për Kadastër, siç ka qenë e përcaktuar në Kontratë .

Nga konfirmimi i Drejtorisë për Planifikim Hapësinorë dhe Mbrojtje të Mjedisit, vërtetohet se personi fizik Vjollca Xh. Gashi si shfrytëzuese afatgjatë e tokës, nuk ka aplikuar për leje të ndërtimit, edhe pse sipas kontratës është obliguar që në këtë parcelë të ndërtoi objektin tërësisht sipas kushteve tekniko-urbanistike dhe lejes për ndërtim që i lëshohet nga organi kompetent i Komunës së Drenasit .

Komisioni konstatoi se shfrytëzuesi afatgjatë i tokës personi fizikë Vjollca Xh.Gashi nga Komorani, sipërfaqen prej 6x12 m, u janë dhënë me qira personave tjerë, operatorëve: Llamarinë punues "SHALA" dhe servisit të pajisjeve të punës " XONI " ndërsa pjesa tjetër e parcelës së dhënë është e pa shfrytëzuar, qe bie ndesh me kontratën.

Nga të gjitha që u thanë me lartë, u propozoj asamblistëve të komunës së Drenasit që në harmoni me legjislacionin në fuqi të shfuqizohet vendimi Nr.12-353-31851, të datës 23.07.2021, respektivisht neni 3 pika 11, që i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prona komunale Vjollca Gashit, me bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 353-46320 e datës 23.10.2014, në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.244/5 me kulture kullosë, në sipërfaqe prej S=0.20 ha, në vendin e quajtur "Stopanica" në zonën kadastrale Komoran

Bashkangjitur gjeni Raportin Nr.01-020/04-15853, të datës 19.04.2021, si dhe dokumentacionin tjetër.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| Pranuar | 19.04. | | 2021 |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 | 020/04- | 15853 | |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KOMUNA DRENAS**
Zyra e Kryetarit

| | |
|---|---|
| **Datë:** | 19.04.2021 |
| **Për:** | **Zyrën e Kryetarit të Komunës së Drenasit**<br>**Kryetarin z. Ramiz Lladrovci** |
| **Nga:** | **Komisioni për verifikimin e përmbushjes së kontratës lidhur me dhënien e pronës së paluajtshme komunle në shfrytëzim afatgjatë, në pjesën e ngastrës nr.244/5, në zonën kadastërale Komoran:**<br><br>**Isak Bytyqi** ______<br>**Armend Hajdini** ______<br>**Fadil Tahiri** ______<br>**Enver Hoxha** ______<br>**Flora Thaqi-Krasniqi** ______ |
| **Lënda:** | **Raport** |

Duke e zbatuar Vendimin e zyrës së Kryetarit të Komunës së Drenasit 01-nr.020/04-15853 të datës 14.04.2021 , me të cilin është formuar komisioni për verifikimin e përmbushjes së kontratës lidhur me dhënin e pronës së paluajtshme komunle në shfrytëzim afatgjatë , pjesën e ngastrës nr.244/5, në zonën kadastërale Komoran , komisioni në përbërje të plotë pas shqyrtimit të dokumentacionit me të cilin posedon dhe verifikimit të gjendjes faktike në terenë paraqet këtë :

# RAPORT

Mbi verifikimin e përmbushjes së kontratës lidhur me dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë, në parcelen nr.244/5 , në zonën kadastërale Komoran .

Komisioni në përbërje të plotë, ka filluar punën me 14.04.2021 , dhe ka verifikuar se:

Në Kontratën me nr.353-me nr.353-46320 të datës 23.10.2014, të lidhur në mes Komunës së Drenasit të cillën e ka përfaqësuar dhe nënshkruar Kryetari i Komunës z.Nexhat Demaku , dhe përsoni fizikë Vjollca Xh.Gashi nga Komorani dhe të cilën e ka nënshkruar e njejta, ku i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtëshme komunale e Komunës së Drenasit, parcela nr.244/5, në sipërfaqe prej 0.20 ha, në vendin e quajtur "stopanica", zona kadastrale Komoran, në të cilën pronë do të ndërtohet objekti për ushtrimin e veprimtarisë: Tregtimi me mekanizëm bujëqsorë, paisje dhe impute bujqësore, në afatë kohorë prej 40 (katërdhjetë) vite, duke filliar prej 22.10.2014 ,me lartësi të kompenzimit prej 0.11 euro për një metër katrorë në vit.

Shfrytëzusi është pajtuar se parcelën e marrë në shfrytëzim do ta shfrytëzoi sipas kritereve, siq janë:

Në këtë parcelë do ta ndërtoi objektin sipas lejes së ndertimit që i lëshohet nga organi kompetent i Komunës së Drenasit që ta filloi punën në afatë prej 6 muajsh, që plani dinamik për realizimin e projektit të jetë 18 muaj, prej ditës së nënshkrimit të kontratës, që të marr lejen për perdorimin e objektit, që të paguaj qiranë, të ndikoj në rritjen e vlerës së pronës , shfrytëzuesi i tokës nuk mund të ia jap të drejten e shfrytëzimit të tokës një personi tjetër, dhe pasë shkëputjes së kontratës, tokën ta kthen në gjendje që e ka marrë .

Pas analizimit të të dhënave të cekura në kontratë dhe konëstatimit të gjendjes faktike në terenë me datën 15.04.2021, të dhënave të konfirmuara nga Drejtoria për Gjeodezi , Kadastër dhe Pronë , Drejtoria për Planifikim Hapsinorë dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, komisioni konstaton se :

Shfrytëzuesi afatgjatë i tokës, nuk e ka regjistruar të drejtën e shfrytëzimit në RDPP, në Sektorin për Kadastër, siqë ka qenë e përcaktuar në Kontratë .

Nga konfirmimi i Drejtorisë për Planifikim Hapsinorë dhe Mbrojtje të Mjedisit , vërtetohet se përsoni fizik Vjollca Xh. Gashi si shfrytëzuese afatgjate e tokës, nuk ka aplikuar për leje të ndërtimit, edhe pse sipas kontratës është obliguar që në këtë parcelë të ndërtoi objektin tërsishtë sipas kushteve tekniko-urbanistike dhe lejës për ndërtim që i lëshohët nga organi kompetent i Komunës së Drenasit .

Sipasë të dhënave të Drejtorisë për Financa, shifet se shfrytëzuesi afatgjatë i tokës Vjollca XH. Gashi në emër të qiramarrjes për 40 vite të 20 ari , ka paguar shumën prej 1.485.00 euro .
Në vendëshiqim me datën 15.04.2021 , komisioni konstatoi se shfrytëzuesi afatgjatë i tokës përsoni fizikë Vjollca Xh.Gashi nga Komorani, sipërfaqen prej 6x12 m , u janë dhënë me qira përsonave tjerë, operatorëve: Llamarinë punues "SHALA" dhe servisit të paisjeve të punës " XONI " ndërsa pjesa tjetër e parcellës së dhënë është e pa shfrytëzuar, edhe pse në kontratë është përcaktuar se shfryetëzuesi i tokës, nuk mundë të ia jap të drejtën e shfrytëzimit të tokës dhe objektin një personi tjetër .

Bashkangjitur këtij raporti po ua paraqesim fotot dhe të gjeturat gjatë matjes.




Sipas matjes në teren sipërfaqja e shfrytëzuar është **2000 m²** . në fundin e parcelës nuk ka kufizime të parcelës as rrethoj, ndërsa sipërfaqja sipasë kontratës dhe sipërfaqja në pjesën grafike e cila është e azhuruar në KADMAP ka mospërputhje pasi parcela e azhuruar në pjesën grafike është: **S= 1619 m²**.




Lokalet e ndërtuara janë **objekte montazh 6x12**, të cilat ju janë lëshuar qera nga shfrytezuesi i kontratës, përsonave tjerë fizik/juridik, konktretisht këtyre operatorëve : **Llamarine punues "SHALA"** dhe **Servis i paisjeve të punës "Xoni "**.

Pjesa e tjetër e parcelës së dhënë nuk është e shfrytëzuar.





Nga komisioni konstatohet se shfrytëzuesi afatgjatë i tokës, përsoni fizik Vjollca Xh.Gashi nga Komorani, nuk i ka përmbush obligimet kontraktuese ndaj Komunës së Drenasit, prandaj komisioni i rekomandon Zyrës së Kryetarit të Komunës së Drenasit që në harmoni me ligjet në fuqi të ndërmarrë masat e duhura për anulimin e kësaj kontrate dhe ta obligoi shfrytëzuesin e gjertanishem që siperfaqen e pronës komunale të cilën e ka marrë në shfrytëzim ta kthejë në gjendjen e mëparshme dhe ta liroi në afatin e caktuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Drenasit.

Me respekt!

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

01- Nr 020/04-15853 dt. 14.04. 2021

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

# VENDIM

**Për formimin e komisionit për verifikimin e përmbushjes së kontratës lidhur me dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë, në pjesën e ngastrës Nr. 244/5, në zonën kadastrale Komoran**

I. Anëtaret e komisionit për verifikimin e përmbushjes së kontratës lidhur me dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë, në pjesën e ngastrës Nr. 244/5 në zonën kadastrale Komoran janë:

1. Isak Bytyqi ( kryetar ),
2. Armend Hajdini( anëtarë ),
3. Fadil Tahiri ( anëtarë ),
4. Enver Hoxha ( anëtarë ),
5. Flora Thaçi - Krasniqi ( anëtarë ).

II. Komisionit për verifikimin e përmbushjes se kontratës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë, në pjesën e ngastrës Nr. 244/5 në zonën kadastrale Komoran, ka për detyrë që të bëjë verifikimin e përmbushjes së kontratës Nr.353-46320, të datës 23.10.2014.

III. Komisionit për vlerësimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë, punën e tyre duhet të kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.

IV. Komisionit për vlerësimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjate, në pjesën e ngastrës Nr. 244/5 në zonën kadastrale Komoran, ka për detyrë që të hartoi raport me shkrim lidhur me përmbushjen e kontratës.

V. Ky komision deri me datë 19.04.2021 duhet të paraqes raport me shkrim, si dhe rekomandime lidhur me veprimet që duhet t'i ndërmarr kryetari i komunës.

VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

**Kryetari i Komunës**

**Ramiz Lladrovci**

Iu dërgohet:

- *Zyrës së Kryetarit;*
- *Zyrës së Personelit;*
- *Anëtareve të Komisionit;*
- *Arkivit të Komunës së Drenasit.*

2017 = D = 00,00 €

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT

NR.353-46320 dt.23/10 2014

# KONTRATË
## MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN E PALUJTSHME TË KOMUNËS.

E LIDHUR MË DATËN 23.10. 2014 NË MES :

1.KOMUNA E DRENASIT të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Nexhat Demaku (në tekstin e mëtejmë: Dhënësi i tokës në shfrytëzim afatgjatë).

dhe

2.Përsoni fizik VJOLLCA XH.GASHI nga Komorani ,me numer personal 1014301123_ të cilën e përfaqëson Vjollca Gashi me seli Komoran , Komuna e Drenasit (në tekstin e mëtejmë: shfrytëzuesi afatgjatë i tokës).

BAZA JURIDIKE:

I.

Është nenit 14.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale,neni 9 paragrafi 5 i Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës,neni 18 paragrafi 6 të Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Vendimit me Nr.353-31851 të datës 23.07.2014 të Kuvendit të Komunës,për dhënien e tokave komunale në shfrytëzim afatgjatë.

OBJEKTI I KONTRATËS:

II.

Është dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës sipas Certifikatës pronësore nr.421-5251 , në zonën kadastrale Komoran,në pjesën e ngastrës nr.244/5,në sipërfaqe prej_0.20_ha,në vendin e quajtur"Stopanica" me kulturë kullosë në të cilën do të ndërtohet objekt për ushtrimin e veprimtarisë:**Tregtimi me mekanizem bujqësorë, paisje dhe impute bujqësore.**

AFATI KOHORË:

III

Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës sipas pikës dy(II)të kësaj kontrate është katërdhjetë(40) vite,nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate nga 22.10.2014 gjer më 21.10.2054 me mundësi të vazhdimit apo shkëputjes duke respektuar Ligjin e zbatueshëm të vitit skadues të kësaj kontrate,si dhe me mundësinë e tërheqjes prej gjashtë (6)muajsh nga dita e paraqitjës së kërkesës nga njëra palë kontraktuese.

ÇMIMI:

IV.

Çmimi për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës sipas pikës dy(II)të kësaj kontrate caktohet në lartësi prej___0.11___€.për $m^2$ në vitë në bazë të çmimit konkurues dhe rekomandimit të komisionit për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht me të favorshme duke filluar nga data_01.04.2015 në fillim të muajit e atë me së largu gjer me datën pesëmdhjetë(15)të muajit vijues në të kundërtën do të ndërpritet kontrata në mënyrë të njëanshëme pa paralajmërim.

OBLIGIMET RECIPROKE

V

Shfrytëzuesi afatgjatë i tokës së paluajtshme të komunës, pajtohët se parcelën e marrë në shfrytëzim afatgjatë do ta shfrytëzoi sipas kritereve të konkursit publik siç janë :

1. Në këtë parcelë do të ndërtoi objektin tërësisht sipas kushteve tekniko-urbanistike dhe lejës për ndërtim që i lëshohët nga organi kompetent i Komunës së Drenasit sipas Konkursit publik për të njëjtin destinim në të kundërtën do të ndërpritet kontrata në mënyrë të njëanshme.
2. Që të filloi punën në afat prej: _6__muajsh ,
3. Plani dinamik për realizimin e projektit qiramarrsi eshtë i obliguar ta përfundoj në afat prej 18 muajve nga dita e nënshkrimit të kësajë kontrate.

3. Plani dinamik për realizimin e projektit qiramarrsi eshtë i obliguar ta përfundoj në afat prej 18 muajve nga dita e nënshkrimit të kësajë kontrate.

4. Që të marr lejen për përdorim të objektit ;

4. Shfrytëzuesi i tokës , nuk mundë të ia jap të drejtën e shfrytëzimit të tokës dhe objektit një personi tjetër ;

5. Shfrytëzuesi i tokës obligohet që ç`do muaj të paguaj qiranë për marrjën e tokës në shfrytëzim , në gjirollogarinë e Komunës së Drenasit nr: 1000650070000022 kodi 40-pranë Autoritetit Bankar të Kosovës.

6. Pas shkëputjës së kontratës përkatësisht kalimit të afatit të kontratës shfrytëzuesi i tokës së paluajtshme të komunës obligohet që tokën e dhënë në shfrytëzim afatgjatë të kthen në gjendje që e ka marrë.

7. Të ndikoj në rritjen e vlerës së pronës të dhënë në shfrytëzim afatgjatë

Dhënësi i tokës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë obligohet që toka e dhënë në shfrytëzim afatgjatë të ipet për interes publik,të mos ketë ndonjë kontest pronësor,të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta,të jetë në pajtim me planin zhvillimor urban dhe rregullues si dhe të dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim pa pengesa shfrytëzuesit..

VI.

Palët kontraktuese u pajtuan se çmimi për shfrytëzimin e tokës komunale sipas kësaj kontrate nuk do të ndryshon nëse shfrytëzuesi paguan çmimin e ofruar sipas konkursit publik në një kiste në të kundërtën do të ndryshohet në bazë të Vendimit të BQK-së,nëse monedha që është e aplikueshme në Republiken Kosovës do të ketë rënie në berzë në % e rënies.

VII

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë, që pas nënshkrimit të kësajë kontrate nga palet kontraktuese të bënë regjistrimin katastral në(RDPP) regjistrat e palujtëshmerive si shfrytëzues i përkohshëm i kësajë toke.

VIII

Kontrata mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshme të tokës komunale është kontratë formale që duhet të përpilohet me shkrim. Çdo gjë që nuk është paraparë sipas kësaj kontrate,do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi tokën ndërtimore,të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore .

IX

Shfrytëzuesi i tokës i bartë shpenzimet e mirëmbajtjes së rregullt të cilat janë të nevojshme për të pasur mundësi të funksionimit si dhe të paguaj shpenzimet e rrymës,të ngrohjes,të ujit dhe komunalit tjera në funksion të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të këtij objekti që do të ndërtohet në këtë tokë ndërtimore dhe pas përfundimit obligohet që tokën ndërtimore ta kthej në gjendje që e ka pranuar.

X

Në rast kontesti sipas kësaj kontrate , kompetente për vendosje do të jetë Gjykata kompetente.

XI

Kjo kontratë është e hartuar në katër ekzemplar të njëjtë prej të cilave nga dy kopje për palët kontraktuese.

**PALËT KONTAKTUESE :**

| | |
|---|---|
| **SHFRYTËZUESI I TOKËS:** | **DHËNËSI I TOKËS NË SHFRYTËZIM** |
| **DREJTORI** | **KRYETARI I KOMUNËS** |
| Vjollca Gashi | Nexhat Demaku |

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA GLLOGOC · REPUBLIC OF KOSOVO · MUNICIPALITY GLLOGOC · REPUBLIKA KOSOVA · OPŠTINA GLLOGOC

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit(Gllogocil)**
Zyra e Kuvendit të Komunës

12 Nr. 353 - 31851 dt 23.07. 2014

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 pika 1.4 si dhe nenit 6 të Ligjit për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës Ligjit Nr. 04/L-144,nenit 34 pika 34.6 te Statutit të komunës Kuvendi i Komunës të Drenasit në mbledhjen e mbajtur me dt.17.07.2014 miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNJEN E TOKAVE KOMUNALE NË SHFRYTËZIM

Neni 1

Aprovohet vendimi i komisionit për ndarjen e parcelave të dhëna në shfrytëzim për periudhen afatëgjate sipas ligjit Nr.04/L-144 për dhënjen e tokave në shfrytëzim.

Neni 2

Ndarja e parcelave ka qenë në përputhje me ligjin për dhënjen e tokave në shfrytëzim Nr. 04/L-144 dhe kritereve të konkursit të shpallur në bazë të numrit të punëtorve, vlerës investive , qmimit të ofruar, dhe veprimtarisë që zhvillon.

Neni 3

Ndarja e parcelave është bërë sipas kësaj renditje :

1.Emri i përfituesit ,,Meha"
Zona Katastrale 577 Komoran
Vlera investive 250,000.00€
Numri i punëtorve 15 vende pune
Sipërfaqja e pranuar 0.20 ha ka kërkuar 0.20 ha

2. Emri i përfituesit ,,Sabi" shpk
Zona Katastrale 126 Komoran
Vlera investive 115,000.00€
Numri i punëtorve 12 vende pune
Sipërfaqja e pranuar 0.60 ha ka kërkuar 0.70 ha

3.Emri i përfituesit :
NTP,, Te Bekimi"
Zona Katastrale 4/11 Komoran
Vlera investive: 150,000.00 €
Numri i punëtorve 8 vende pune
Sipërfaqja e pranuar 0,15 ha ka kerkuar 0.20 ha

4. Emri i përfituesit ,,Kalaja e Gurit"
Zona Katastrale 4/11 Komoran
Vlera investive 115,000.00€
Numri i punëtorve 49 vendë pune
Sipërfaqja e pranuar 0.15 ha ka kërkuar 0.17 ha

5. Emri i përfituesit ,, Servis Xhema "
Zona Katastrale 4/11 Komoran
Vlera investive 440,000.00 €
Numri i punëtorve 18 vende pune
Sipërfaqja e pranuar 0.10 ha ka kërkuar 0.17 ha

6. Emri i përfituesit Naser M Gashi
Zona Katastrale 4/11 Komoran
Vlera investive 150,000.00€
Numri i punëtorve 9 vende pune dhe rritje 27% për çdo vit
Sipërfaqja e pranuar 0.10 ha ka kërkuar 0.15 ha

7. Emri i përfituesit NTP ,,Ilirija "
Zona Katastrale 4/11 Komoran
Vlera investive 1,008,000.00 €
Numri i punëtorve 18 vende pune
Çmimi i ofruar
Sipërfaqja e pranuar 0.20 ha ka kërkuar 0.40 ha

8. Emri i përfituesit NTP ,,Mali – com "
Zona Katastrale 4/11 Komoran
Vlera investive 130,000.00 €
Numri i punëtorve 8 vende pune
Sipërfaqja e pranuar 0.10 ha ka kërkuar 0.15 ha

9. Emri i përfituesit
DPZ "KRONI"
Zona Katastrale 4/11 Komoran
Vlera investive 350,000.00 €
Numri i punëtorve 30 vende pune
Sipërfaqja e pranuar 0.15 ha ka kërkuar 0.40 ha

10. Emri i përfituesit ,, Natyra "
Zona Katastrale 780-0 Tërstenik
Vlera investive 200,000.00 €
Numri i punëtorve 8 vende pune
Sipërfaqja e pranuar 0.20 ha ka kërkuar 0.20 ha

11. Emri i përfituesit Vjollca Gashi
Zona Katastrale 244/5 Komoran
Vlera investive 350,000.00 €
Numri i punëtorve 14 vende pune
Sipërfaqja e pranuar 0.16 ha ka kërkuar 0.16 ha

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Bazaj